

Njoftim per vend vakant – RISK MANAGER

DEPARTAMENT	<i>Operacionet</i>
Orari	Kohë e Plotë

Ekipi ynë i **Menaxhimit të Riskut** është në qendër të EasyPay. Ky departament strategjik punon ngushtë me departamente të ndryshme për të monitoruar performancën dhe për të siguruar që biznesi të jetë gjithmonë në një bazë të sigurt. Ne jemi në kërkim të një **Menaxheri/e të Riskut** për të mbështetur **hartimin, zbatimin dhe integrimin e kuadrit të Menaxhimit të Riskut të EasyPay**. Pozicioni do të jetë pjesë e ekipit që përcakton qasjen e menaxhimit të rrezikut, duke marrë parasysh **strategjinë e biznesit** nga ekzekutivi.

Rolet dhe Përgjegjësitë:

- Krijon dhe mirëmban sistemin e administrimit të rrezikut, duke përfshirë identifikimin, vlerësimin si dhe çdo mase te nevojshme për zbutjen apo eliminimin e rrezikut.(identifikim, vlerësim, matje, kontroll , zbutje, monitorim te vazhdueshme,, si dhe raportim ad hoc dhe periodik)
- Monitorim e ekspozimit te rrezikut , dhe vlerëson nevojën për kapital ne mënyrë te vazhdueshme.
- Raportim ne mënyrë te drejtpërdrejtë dhe te pavarur te drejtori ekzekutiv për çështje te lidhura me rrezikun ne kompani. per te siguruar qe rreziqets jane mitiguar sic duhet dhe ne pershtatshmeri me prioritetet dhe objektivat e biznesit.
- Përgatit dhe raporton në mënyrë periodike mbi nivelin e rrezikut dhe masat qe duhet te ndërmerren ne përputhje me rregulloret/procedurën e brendshme dhe kërkesat e Autoriteteve rregullatorë. Monitorimi i profilit të riskut të institucionit duke përdorur KRIs (Key Risk Indicators), incidentet dhe mjetet e tjera të monitorimit të riskut.
- Promovon ndërgjegjësimin dhe kulturën e menaxhimit te rrezikut.
- Harton/ rishikon dhe përmirëson rregullat / proceset e brendshme per menaxhimin e rrezikut dhe implementon praktikat më të mira.
- Anëtar i Komitetit të Riskut dhe Komitetit të Kontrollit për rishikimin dhe miratimin e vendimeve në lidhje me kontrollet/ veprimet korrigjuese të kërkuara për respektim të plotë të standardeve në fuqi dhe rishikimit të pranimi të rrezikut
- Përgjegjës për monitorimit e mashtrimeve te brendshme dhe te jashtme dhe cdo rrezik që mund të shkaktojë Humbje Operacionale për kompaninë: identifikimi i rrezikut, parandalimi, dhe në rast materializimi, minimizimi i humbjes dhe/ose raportimi i duhur i saj.

- Sigurohet që njeh mirë platformat në EasyPay që procesojnë, ruajnë dhe transmetojnë të dhëna konfidenciale apo të dhëna që janë “business-critical”
- Promovon ndërgjegjësimin dhe kulturën e menaxhimit të riskut në të gjithë institucionin. Përgjegjës për mbarëvajtjen dhe menaxhimin e riskut në kompani.
- Bashkëpunon ngushtë me “Compliance Manager” për të bërë të mundur aplikimin sa më të mirë të rregulloreve dhe ligjeve në fuqi që kanë lidhje me riskun në institucionet financiare

Kërkesat dhe njohuritë e nevojshme

- Diplomë Bachelor ose Master në Financë, Ekonomi, Administrim Biznesi ose fusha të ngjashme.
- Minimumi 2-5 vite përvojë në menaxhimin e rrezikut, analizën financiare, auditimin ose sektorin bankar.
- Eksperiencë në analiza financiare, auditim, raportim risku & menaxhim i projekteve. Përvojë praktike në hartimin dhe zbatimin e kuadrove të ERM (Enterprise Risk Management) në një mjedis të shërbimeve financiare (preferohet në banka dhe/ose institucione pagesash).
- Njohuri të mira mbi kuadrin rregullator financiar që ndikon në menaxhimin e riskut.
- Aftësi për të punuar në ekip dhe për të komunikuar në mënyrë efektive me departamente të ndryshme.
- Të jetë proaktiv dhe i/e kujdesshëm ndaj detajeve.

Personat e interesuar duhet të dërgojnë CV-në në adresën e-mail: hr@easypay.al

Të gjitha për aplikimet do të trajtohen në konfidencialitet të plotë. Bazuar në ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, neni 12 -17, informacioni personal i depozituar për aplikimin punësim do të përdoret vetëm për këtë qëllim.

Ju informojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen nga Departamenti i Burimeve Njerëzore mirëpresim!

Afati fundit për të aplikuar 24/02/2025